



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:175251

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05340278

KPPP.nr. 1291/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Petrol Company” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810527195 dhe me seli në Zona Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, p.nr., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1198/23, i lejuar me datë 28.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 16.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimit i debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1198/23, i lejuar me datë 28.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 1198/23, i lejuar me datë 28.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 2898/23, e datës 31.05.2023; Faturës nr. 2268/23, e datës 30.04.2023; Faturës nr. 2267/23, e datës 30.04.2023; Faturës nr. 1625/23, e datës 31.03.2023; Faturës nr. 6871/22, e datës 31.12.2022, si dhe; Faturës nr. 4728/22, e datës 30.09.2022, ka lejuar Urdhrit

Përmbarrimor P.nr. 1198/23, të datës 28.07.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 20,513.20, me kamatëvonesë prej 8 %, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marr urdhri përmbarrues nuk është dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar, ashtu siç parashihet me dispozitat e LPP-së. Më tej, ka theksuar se propozimit për përmbarrim nuk i janë bashkangjitur faturat në origjinale apo kopje të vërtetuara sipas ligjit dhe rrjedhimisht këto fatura nuk i plotësojnë kushtet për të shërbyer si dokumente të besueshme. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që hedhë poshtë urdhrin përmbarrimor.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimi për përmbarrim është paraqitur në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave, të cilat i përmbajnë të gjitha elementet për të qenë dokumente të besueshme. Ka shtuar se faturat janë pranuar nga debitori, janë nënshkruar dhe protokolluar nga i njëjti pa asnjë vërejtje, si dhe debitori në vazhdimësi ka qenë i njoftuar nëpërmjet email-it për rrjedhshmërinë e borxheve të tij dhe se në rast të mos pagesës së obligimit lënda do të procedohet tek përmbarruesi. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër,

sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se përmbarduesi privat ka lejuar urdhrin përmbardimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave të përshkruara si në hyrje të arsytimit të këtij aktvendimi, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se faturat janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa janë pranuar nga debitori i cili të njëjtat i ka nënshkruar dhe vulosur, ndërsa nuk i ka kundërshtuar më parë.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbardimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbardim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbardimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1291/23, datë 16.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.